

PROCESVERBAL TERRENI

Institucioni: Bashkia Maliq
Sektori: Pyjeve dhe Kullotave

Vendndodhja e inspektimit:

Në terren përgjatë lumit Devoll, në segmentin nga **Maliq** në drejtim të **Lozhanit** me kordinata X:471379.85 dhe Y:4508157.42 ku fillon segmenti dhe me kordinata X:468216.90 dhe Y:4508866.20 ku perfundon segmenti.

Grupi i punës:

Në bazë të urdhrimit të punës Nr.10, datë 05. 05. 2026, në terren u paraqit grupi i punës i përbërë nga:

Grupi 1 (krahu i rruges)

Grupi 2 (krahu i kundert)

- Grupi është ndarë në dy nën-grupe dhe ka mar në formë paralele (gjatesore) të dyja anët e lumit Devoll me kordinata si më lartë.

Qëllimi i daljes në terren:

Matja dhe evidentimi i sipërfaqes (në m^2) ku ndodhen filiza me diametër 0 në 10 cm. Evidentimi i numrit të pemëve të rritura, për të cilat parashikohet ngritja e kurorës, me diametër nga 10 deri në 20 cm.

Përshkrimi i punimeve të kryera:

Grupi i punës u nda në dy nën-grupe, të cilat operuan paralelisht në të dyja anët e lumit, sipas koordinatave të përcaktuara më sipër.

Gjatë verifikimit në terren u realizuan këto procese:

- Matja dhe evidentimi i sipërfaqes (në m^2) ku ndodhen filiza me diametër deri në 10 cm;
- Evidentimi i pemëve të rritura me diametër nga 10 deri në 20 cm, për të cilat parashikohet ngritja e kurorës.

TË DHËNAT E KONSTATUARA NË TERREN

Nr	Segmenti / Vendndodhja	Sipërfaqe me filiza (m²)	Nr. pemësh (10–20 cm)
1	Maliq – Lozhan krah i rruges	11250	1600
2	Maliq – Lozhan krah i kundert I rruges	8430	1250
3	Totali	19680	2850

Përfundime:

Nga verifikimi në terren rezulton se:

- Sipërfaqja totale me filiza që do ndërhyet është: 19680 m²
- Numri total i pemëve për ngritje kurore: 2850 copë
- Gjendja e përgjithshme nga terreni është se midis degeve të pemëve në filizëri dhe ne degët e pemëve deri në lartësin 2.5 m ka grumbullim të mbetjeve plastike që kanë ngecur midis degëve.

Rekomandime:

- Të ndërhyhet me ngritje kurore për pemët e evidentuara deri në lartësin 2.5 m.
- Të ndërhyet në pjesa e filizave të evidentuara që janë të pa dobishëm dhe në to kryhet grumbullimi i mbetjeve plastike .
- Të merren masa për mbrojtjen e lumenjve nga hedhja e mbeturinave për ta menaxhuar dhe parandaluar që në burim këtë ndotje mjedisore që bëhet dhe pengesë në lëvizjen e ujit

➤ **Procesverbali u mbajt në terren dhe pasi u lexua, u firmos nga të pranishmit:**

Grupi i punës: